



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01. Nr. 104/02-27924/21
Kaçanik, 16.09.2021

Në bazë të nenit 12.2(d) lidhur me nenin 14.1 dhe 17 të Ligjit Nr. 03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare nr. 28/2008 e datës 4 qershor 2008), të nenit 6.2 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 16 Shtator 2021, mori këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E PROPOZIM VENDIMIT 01NR. 104/02-27924/21 I DATËS 09.09.2021 - PËR APROVIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE KOMUNALE TË PLANIFIKUARA PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM NË VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, REFUZOHET Propozim Vendimi i Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-27924/21 i datës 09.09.2021- për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të planifikuara për dhënie në shfrytëzim në vitin 2022.
2. Refuzimi i Propozim Vendimit si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet me arsyetim së i njëjti është propozuar në kohë fushate të Zgjedhjeve lokale.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Urbanizimit Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit; dhe
3. Arkivi.





Data	09.09.21	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	104/02-27324 -1
		Shtojcë	

09.09.2021
KAÇANIK

Në bazë nenit 58, shkronja h) e Ligjit Nr. 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, Kryetari i Komunës së Kaçanikut nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit bënë këtë:

PROPOZON

Në bazë të nenit 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr.10/03 Prill 2019), neni 6 par.1 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenit 6 shkronja h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës propozon që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë _____2021, të merr këtë:

VENDIM

PËR APROVIMIN E LISTËS SË VEÇANTË TË PRONAVE KOMUNALE

TË CILAT DO TË JEPEN NË SHFRYTËZIM NË VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Lista e Veçantë e pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022, si vijon:

1.1 Zona kadastrale Bob:

1. Parcela kadastrale, nr. 00247-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.40.14 ha;

1.2 Zona kadastrale Ivajë:

1. Parcela kadastrale, nr. 00281-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.71.55 ha;
2. Parcela kadastrale, nr. 00299-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 01.26.74 ha;
3. Parcela kadastrale, nr. 00300-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.78.76 ha.

1.3 Zona kadastrale Kaçanik:

4. Parcela kadastrale, nr. 00568-2, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.76.68 ha;
5. Parcela kadastrale, nr. 00888-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.45.31 ha;
6. Parcela kadastrale, nr. 00889-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.88.63 ha.
7. Parcela kadastrale, nr. 00890-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 02.09.99 ha;
8. Parcela kadastrale, nr. 00891-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.51.89 ha.

1.4 Zona kadastrale Kotlinë:

9. Parcela kadastrale, nr. 00068-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.19.60 ha;
10. Parcela kadastrale, nr. 00232-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 02.01.36 ha;

1.5 Zona kadastrale Rekë:

11. Parcela kadastrale, nr. 00087-1, në sipërfaqe të tërsishme prej 01.80.54 ha;

1.6 Zona kadastrale Kaçanik i Vjetër:

1. Parcela kadastrale, nr. 00728-0, në sipërfaqe të tërsishme prej 00.46.84 ha.

2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të kësaj liste, është për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe përmbushjes së interesit të përgjithshëm të qytetarëve.

3. Lista e veçantë e pronave komunale të cilat do të jepen në shfrytëzim në vitin 2022 të përcaktuara si në këtë vendim, do të bëhet publike në Faqen Zyrtare të Komunës.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi do Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga MAPL.

